REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

VENDIM

Nr. 537, datë 14.12.2022
PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {…} PËR VITIN 2021

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 "Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve" dhe nr. 264, datë 21.11.2019, "Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit", pasi shqyrtoi "Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {…}, për vitin 2021", i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

V E N D O S I :

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {…} për vitin 2021", duke e vlerësuar atë si më poshtë:
   - **A.** Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";
   - **B.** Aftësitë organizative – "Shumë mirë";
   - **C.** Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";
   - **D.** Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".
     Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shumë mirë".

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {…} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja parashtron në mënyrë të detajuar faktet e çështjes, në një pjesë të veçantë dhe të dallueshme të pjesës përshkruese-arsyetuese të titulluar "Rrethanat e çështjes", pavarësisht natyrës së gjykimit të zhvilluar *(gjykim si shkallë e dytë mbi bazë ankimi apo si juridiksion fillestar)*. Paraqitja e fakteve të çështjes, duke iu referuar vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja apo atyre të përzgjedhura me short, nxirret nëpërmjet analizës së integruar të provave të administruara gjatë gjykimit në shkallë të parë, por edhe gjatë gjykimit në apel, në ato raste kur është riçelur pjesërisht hetimi gjyqësor,[1] apo në rastet kur gjykata e apelit ka shqyrtuar çështjen në bazë të juridiksionit fillestar që ajo ka, për shkak të kompetencës funksionale.[2] Në çështjet me juridiksion fillestar evidentohet se faktet e çështjes gjenden edhe në pjesën e vlerësimit ligjor të gjykatës mbi bazueshmërinë në ligj dhe në prova të pretendimeve të ngritura në kërkesëpadi.[3] Në çështjet e shqyrtuar mbi bazë ankimi, evidentohet kujdesi i duhur që gjyqtarja tregon për cilësimin e saktë të veprimeve që përbëjnë fakte juridike, pavarësisht nëse përcaktimi i gabuar ose jo i faktit, ka përbërë ose jo shkak ankimi. Kjo, sepse përcaktimi i saktë i faktit lidhet prej saj në çdo rast me analizimin e shkaqeve të ankimit dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjeve, në vendimet e analizuara, evidentohet se gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të gjykatës, duke cituar dhe analizuar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale,[4] në lidhje me kompetencën lëndore dhe funksionale për shqyrtimin e çështjes.

---

[1]Vendimi nr.578, datë 19.11.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[2]Vendimet nr.66, datë 04.10.2021, nr.47 (86-2021-461), datë 24.06.2021 dhe nr.44 (86-2021-427), datë 16.06.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit.

[3]Vendimet nr.66, datë 04.10.2021 dhe nr. 44 (86-2021-427), datë 16.06.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit.

[4]Vendimet nr.44 (86-2021-427), datë 16.06.2021 dhe nr.66, datë 04.10.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në vendimet burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

Sa i përket ligjit procedural, gjyqtarja ka referuar dhe cituar në disa raste:

- nenet 44, 45 dhe 46 të ligjit 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar dhe nenin 454 të K.Pr.Civile, në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, *(afati, forma, përmbajtja, paraqitja përpara gjykatës kompetentet, nga subjektet e legjitimuar në të drejtën e ankimit si dhe jashtë kushteve ndaluese)*;[5]
- nenin 50/ç të ligjit 49/2012 lidhur me verifikimin e respektimit të standardeve të procesit të rregullt gjyqësor të zhvilluar nga gjykata e shkallës së parë, për të cilat ligji parashikon pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit; nenin 51/1 shkronja "c" të ligjit 49/2012 lidhur me kalimin e çështje për shqyrtim në seancë gjyqësore me qëllim konstatimin e drejtë të rrethanave së faktit; nenin 465 të K.Pr.Civile në lidhje me nenin 12/2 të ligjit 49/2012 lidhur me riçeljen e pjesshme të hetimit gjyqësor; nenin 53/b te ligjit 49/2012 në lidhje me disponimin për ndryshimin e vendimit të shkallës së parë; nenin 106 të K.Pr.Civile në lidhje me nenin 66/2 të ligjit 49/2012 për ngarkimin e shpenzimeve palës së paditur;[6]
- nenin 28/4 të ligjit 49/2012 lidhur me kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë, e cila jepet në çdo fazë dhe shkallë të shqyrtimit gjyqësor, derisa vendimi nuk ka marrë formë të prerë; nenet 29 dhe 30 të ligjit 49/2012 lidhur me kushtet kumulative që duhet të ekzistojnë për vendosjen e masës së sigurimit, si dhe llojet e masave për sigurimin e padisë;[7]
- nenin 37 të ligjit nr. 49/2012, në lidhje me kufijtë e shqyrtimit nga gjykata mbi ligjshmërinë e veprimit administrativ;[8]
- nenin 1 të ligjit nr.49/2012 në lidhje me efektin plotësuese që ka Kodit i Procedurës Civile në zbatimin e ligjit nr. 49/2012, përsa në këtë ligj nuk është parashikuar ndryshe dhe nenin 201/a të K.Pr.Civile lidhur me disponibilitetin e palës paditëse për të hequr dorë nga e drejta e padisë;[9]
- nenet 7 shkronja "a", 10 shkronja "b" të ligjit 49/2012 dhe nenet 97 dhe 100/1 të ligjit 115 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, me qëllim analizimin e juridiksionit, kompetencës lëndore dhe asaj funksionale të gjykatës administrative të apelit në shqyrtimin e ankimit ndaj aktit administrativ individual të Këshillit të Lartë Gjyqësor; nenin 15 të ligjit 49/2012 në lidhje me interesin e ligjshëm në ngritjen e padisë, nenin 2/1 të ligjit 49/2012 në funksion të përkufizimit të kuptimit të "*veprimit administrativ*", nenin 100 të ligjit 115/2016 në lidhje me ushtrimin e të drejtës së padisë brenda afatit ligjor; nenin 16 të ligjit 49/2012 në lidhje me kushtin për shterimin e ankimit administrativ;[10]
- nenet 7 shkronja "a" dhe 10/2 shkronja "b", në lidhje me nenin 19/1 të ligjit nr.133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompletimit të pronave" me qëllim analizimin e kompetencës lëndore dhe asaj funksionale të gjykatës administrative të apelit për gjykimin e padive me objekt kundërshtim të vlerësimit financiar të kryera nga ATP; nenin

---

[5]Vendimet nr.578, datë 19.11.2021, nr.67 (86-2021-83), datë 01.02.2021, nr.310 (86-2021-390), datë 08.06.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit

[6]Vendimi nr.578, datë 19.11.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[7]Vendimi nr.34, datë 07.09.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[8]Vendimet nr.67 (86-2021-83), datë 01.02.2021 dhe nr.66, datë 04.10.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit

[9]Vendimi nr.310 (86-2021-390), datë 08.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[10]Vendimi nr.66, datë 04.10.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

15 të ligjit 49/2012 në lidhje me legjitimitetin aktiv të palës paditëse; nenin 18 të ligjit 49/2012 në lidhje me afatin e paraqitjes së padisë; nenin 16 ligjit 49/2012 në lidhje me kushtin për shterimin e ankimit administrativ; nenin 17/2 të ligjit 49/2012 në lidhje me të drejtën e gjykatës për të bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, pa e lidhur atë me mënyrën e prezantimit të palëve; neni 106/1 të K.Pr.Civile lidhur me shpenzimet gjyqësore; [11]

- nenin 2/2 të ligjit 49/2012 dhe nenin 3/2 të K.Pr.Administrative lidhur me përkufizimin e "*aktit nënligjor normativ*"; nenet 29 dhe 73/4 të ligjit 26/2019 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat" në lidhje me legjitimimit aktiv dhe legjitimitetit pasiv, nenin 18/3 të ligjit 49/2012 në lidhje me afatin e kundërshtimit të aktit nënligjor normativ.[12]

Sa i përket dispozitave të ligjit material të zbatueshëm, gjyqtarja ka identifikuar, referuar, dhe në disa raste ka cituar dispozita të Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjet objekt shqyrtimi. Konkretisht, në vendimet e analizuara gjyqtarja referon dispozita të ligjit material, si më poshtë:

- dispozitat e ligjit nr.133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", i ndryshuar, *(nenet 1, 2, 19/1, 6-8)* në lidhje me objektin dhe qëllimin e ligjit, të drejtën e palës së interesuar për t'u ankuar kundër vlerësimit financiar të kryer, metodologjinë e vlerësimit, si dhe format e kompensimit dhe vlerësimit;[13]
- dispozitat e ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, *(nenet 3 dhe 4)* në lidhje me vlerat themelore të magjistratit në drejtim të integritetit dhe sjelljes, Kodin e Etikës Gjyqësore, miratuar me vendimin nr.171, datë 22.04.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me një nga standardet e parashikuar në këtë kod, atë të "*sjelljes së hijshme dhe me vetëpërmbajtjet*"; nenin 152 të ligjit 96/2016, me ndryshimet që pësuan me ligjin nr.48/2019 dhe nr.15/2020, lidhur me pezullimin e magjistratit në rastet e procedimit disiplinor; nenin 153 lidhur me organin kompetent publik dhe mënyrën e caktimit të masës së pezullimit të magjistratit; nenet 12 dhe 109 të K.Pr.Administrative, nenin 100/1 shkronja "e" e Ligjit për Statusin, në funksion të analizës së parimi i propocionalitetit kërkon që masa që merret në kuadër të procedimit disiplinor ndaj magjistratit, duhet të jetë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë;[14]
- nenin 7 të ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", në lidhje me kushtet kumulative që duhet të plotësohen për regjistrimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi, të paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, i marrë në analizë me edhe me nenin 68 të këtij ligji, në lidhje me vijimin e procedurave administrative dhe ato gjyqësore të nisura dhe të papërfunduara në kuadër të ligjit nr.9948/2008;[15]
- nenet 73 dhe 80 të ligjit nr.26/2019 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", lidhur me natyrën dhe kompetencat e dhëna Komisionit Disiplinor si organ vendimmarrës në proceset disiplinore që zhvillohen ndaj përmbaruesve gjyqësorë privat;[16]
- nenin 5 i ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit", VKM nr.277, datë 18.06.1997 "Për përfitimin nga statusi i të verbrit", i ndryshuar; dispozitat e ligjit nr.9355/2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar *(nenet 1, 2, 3, 4, 7, 8, 11,*

[11]Vendimi nr.44 (86-2021-427), datë 16.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[12]Vendimi nr.47 (86-2021-461), datë 24.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[13]Vendimi nr.44 (86-2021-427), datë 16.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[14]Vendim nr.66, datë 04.10.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[15]Vendimi nr.67 (86-2021-83), datë 01.02.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[16]Vendimi nr. 47(86-2021-461), datë 24.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

20, 23) në lidhje me statusin e të verbrit, dhe në mënyrë specifike kategorinë e të verbërve, qëllimet, objektivat e kuadrit ligjor dhe detyrimet e posaçme që ka shtetit dhe shoqëria për t'i siguruar kësaj kategorie të gjitha mjetet efektive për realizimin e të drejtave dhe krijimin e të gjitha kushteve për integrimin e tyre në jetën normale.[17]

Krahas dispozitave dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 52 të Kushtetutës, nenin 9 të Deklaratës Universale e të Drejtave të Njeriut, në lidhje me të drejtën për mbrojtjen shoqërore në përgjithësi dhe e drejta për pension në veçanti; nenet 1 dhe 13 të Konventës së OKB "*Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar*", në lidhje me mbrojtjen që gëzojnë të gjithë personat me aftësi të kufizuar për realizuar në mënyrë të plotë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut; Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) si akt në të cilin janë përcaktuar standardet minimale ndërkombëtare në lidhje me të drejtat që përfitohen nga sigurimet shoqërore;[18]
- nenin 147 të Kushtetutës, në lidhje me legjitimimin pasiv në padi të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organ kushtetues i cili siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushteti gjyqësor në Republikën e Shqipërisë; nenin 140 të Kushtetutës për sa i takon procedimit disiplinor të gjyqtarit; Kartën Europiane mbi Statusin e Gjyqtarëve, Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit"; [19] Komentari mbi Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, në lidhje me vlerat thelbësore që duhet të udhëheqin çdo gjyqtar jo vetëm gjatë ushtrimit të funksionit të tij, por edhe në jetën e tij private;[20]
- neni 41 i Kushtetutës lidhur me të drejtën e pronësisë si një e drejte e garantuar por se ka raste të kufizimit të pronësisë private *(shpronësimi apo kufizime që barazohen me shpronësimin)*;[21]
- nenin 118 të Kushtetutës, lidhur me mishërimin e dy parimeve të rëndësishme kushtetuese, *rezervën ligjore dhe parimi i epërsisë së ligjit*, nenin 102/4 të Kushtetutës në lidhje me kompetencën e Ministritë të Drejtësisë, si organ kushtetues, të nxjerr aktin nënligjor, objekt gjykimi.[22]

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet e analizuara nuk rezulton të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural ose material, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin dhe analizën e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

---

[17]Vendimi nr.578, datë 19.11.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[18]Vendimi nr.578, datë 19.11.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[19]Miratuar me Rezolutat 40/32, datë 29.11.1985 dhe 40/146, datë 13.12.1985 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB

[20]Vendimi nr.66, datë 04.10.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[21]Vendimi nr.44 (86-2021-427), datë 16.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[22]Vendimi nr.47 (86-2021-461), datë 24.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 25 pikë.*

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t'i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik**,** rezulton se në vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështje. Në çdo rast citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtares sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin ligjor të normës konkrete *(ratio legis - për të cilën ajo është krijuar)* dhe, duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, arrin në konkluzionin në lidhje me shkaqet e ankimit apo për t'i dhënë përgjigje pretendimeve të palëve në rastet kur ato kanë qasje tjetër ndaj qëllimit të ligjit. Gjithashtu konstatohet edhe interpretimi i normës juridike në këndvështrimin sistematik të tyre, apo në këndvështrimin historik *(ndryshimet e ligjeve)*, duke u ndalur në krahasimin e formulimit të dispozitës para dhe pas ndryshimeve që ajo ka pësuar. Në të gjitha vendimet gjyqësore dispozitat ligjore të evidentuara si të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, shoqërohen me interpretimin e kuptimit dhe qëllimit të tyre, para aplikimit mbi faktet konkretet në shërbim të të cilit ato analizohen.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm, evidentohet se interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet te plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës. Interpretimi i normës lidhet gjithmonë me faktet e provuara. Konkretisht, në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, evidentohet se gjyqtarja:

- interpreton në mënyrë të përgjithshme dhe në mënyrë historike institutin e pezullimit nga detyra të magjistratit duke evidentuar se deri në ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 ky institut procedural nuk njihej në kuadër të procedimit disiplinor të gjyqtarëve. Me ndryshimet kushtetuese u sanksionua instituti i pezullimit nga detyra të gjyqtarit duke parashikuar rregullime të veçanta në nenin 140 pika 3 të Kushtetutës dhe në nenin 152 të ligjit nr.96/2016 *(dispozitë e shfuqizuar më pas me vendimin nr.34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe e ndryshuar kjo dispozitë me ligjin nr.48/2019 dhe ligjin nr.15/2020)*. Gjithashtu, interpreton nenet 152 dhe 153 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e

gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" lidhur me detyrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për procedimin disiplinor të gjyqtarëve;[23]

- interpreton nenin 35 i ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", që sanksionon kushtet e përfitimit të pensionit të invaliditetit. Gjyqtarja interpreton në mënyrë të përgjithshme ligjin nr.9098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit", si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, konkretisht Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.227, datë 18.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", i ndryshuar, si dhe Urdhrin nr.47/1, datë 11.01.2018 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë në punë për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuar dhe komisionit mjekësor të përcaktimit të të verbrit". Gjithashtu, interpreton nenet 1-4, 7, 11, 20, 23 të ligjit nr.9335/2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, lidhur me qëllimet e ligjit, parimet, përkufizimet, përfituesit e pagesës për aftësi në e kufizuar, forma e pagesës dhe ndihma ekonomike;[24]
- interpreton në mënyrë të përgjithshme ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", duke u ndalur në mënyrë të veçantë te qëllimi i ligjit, si dhe mënyra e ndarjes së tokës së ish ndërmarrjeve bujqësore. Po kështu, gjyqtarja interpreton në mënyrë të përgjithshme dhe sistematike aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", VKM nr.255, datë 02.08.1991 "Për kriteret e ndarjes së tokës" si dhe VKM nr.452, datë 17.10.1992 "Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve Bujqësore". Interpreton në mënyrë të përgjithshme ligjin nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", lidhur me verifikimin e ligjshmërisë së akteve të marrjes së tokës në pronësi. Në vijim, gjyqtarja interpreton në mënyrë specifike nenin 7 të ligjit, me qëllim analizimin e kushteve kumulative në regjistrimin e AMTP nga ASHK, për të vijuar më pas me interpretimin sistematik të kësaj dispozite me nenin 68 të ligjit 9948/2008, dispozitë e cila parashikon vijimin e procedurave administrative dhe ato gjyqësore të nisura e të papërfunduara në kuadër të ligjit nr.9948/2008. Në këtë kuadër evidentohet se gjykata zbaton parimin e zbatimit të ligjit të kohës.[25]
- Në funksion të vlerësimi nëse është respektuar afati dhe procedura e njoftimit për paditësin apo personave të tjerë të interesuar lidhur me procedurën administrative gjyqtarja interpreton në mënyrë sistematike dispozitat ligjore të sanksionuara në nenet 147, 148 pika 2, 161 dhe 163 të K.Pr.Administrative, lidhur me përcaktimin e komunikimit të organit publik me palën apo subjektet e interesuara, të përfshira në një procedurë administrative, veprimin administrativ apo procedural me anë të njoftimit si dhe format e tij. Gjithashtu, gjyqtarja interpreton nenet 1, 2, 5, 6-8, 14 pika 2, 16 pika 1, 19, 27 të ligjit nr.133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", lidhur me objektin dhe qëllimin e ligjit, metodologjinë e vlerësimit financiar, si dhe format e kompensimit, mënyrën e njoftimit për vlerësimin financiar nëpërmjet regjistrit elektronik, afatin e njoftimit, të drejtën e ankimit të palës së interesuar kundër vlerësimit financiar si dhe formën e shprehjes së ATP në ushtrimin e funksionit të saj publik. Dispozitat ligjore të mësipërme gjyqtarja i interpreton edhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit, konkretisht me VKM nr.223, datë 23.03.2016 "Për caktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave", VKM nr.89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës e vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", si dhe VKM nr.1114, datë 24.12.2020

[23]Vendimi nr.66, datë 04.10.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[24]Vendimi nr.578, datë 19.11.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[25]Vendimi nr.67 (86-2021-83), datë 01.02.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.223, datë 23.03.2016 të Këshillit të Ministrave".[26]

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale, gjyqtarja interpreton dispozitat në disa raste, si më poshtë:

- interpreton në mënyrë sistematike nenet 10 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, me nenet 97, 100 pika 1 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", lidhur me kompetencën lëndore dhe funksionale të Gjykatë së Apelit Administrativ në funksion të konkluzionit se ligji specifik ka përcaktuar kompetencën lëndore dhe funksionale të Gjykatës Administrative të Apelit për gjykimin e padive me objekt kundërshtimin e akteve individuale të Këshillit të Lartë Gjyqësor;[27]
- interpreton në mënyrë të përgjithshme dhe sistematike ligjin nr.49/2012 me nenin 1 të K.Pr.Civile, me qëllim evidentimin e natyrës plotësuese të ligjit, duke argumentuar se në kushtet kur në ligjin nr.49/2012 nuk ka një parashikim ligjor lidhur me gjykimin në Gjykatën Administrative të Apelit, gjykata i referohet parashikimeve në K.Pr.Civile. Aplikon nenin 201 shkronja "a" të K.Pr.Civile, lidhur me të drejtën e paditësit për të hequr dorë nga e drejta e padisë dhe pasojat juridike të saj, kur gjykimi ndodhet në Gjykatën e Apelit Administrativ;[28]
- interpreton nenin 46 të ligjit nr.49/2012, lidhur me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, duke e lidhur specifikisht me pagesën e tarifës gjyqësore. Në këtë kontekst gjyqtarja interpreton pikën 3 të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë nr.2668, datë 20.11.2013, lidhur me detyrimin ligjor për pagesën e tarifës gjyqësore, në rastin e ushtrimit të së drejtës së ankimit;[29]
- interpreton nenet 29 dhe 30 të ligjit nr.49/2012 mbi kriteret ligjore të sigurimit të padisë dhe llojeve të sigurimit të padisë, si dhe nenin 2, pika 7 të ligjit nr.49/2012 me qëllim analizimin e masës së sigurimit "*pezullimin e zbatimit të veprimit administrativ"*;[30]
- interpreton nenet 7, 10, 15, 16, 18 të ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" mbi kushtet e pranueshmërisë së padisë *(juridiksionin gjyqësor, kompetencës lëndore dhe funksionale të gjykatës, legjitimitetin aktiv dhe pasiv të ngritjes së padisë, afatin ligjor për kundërshtimin e aktit administrativ si dhe shterimin e ankimit administrativ si kusht formal në ngritjen e padisë);*[31]
- në funksion të analizimit të ligjshmërisë së aktit administrativ të kundërshtuar nga paditësi, gjyqtarja i referohet parimit procedural të gjykimit administrativ të sanksionuar në nenin 37, pika 1 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", parim sipas të cilit gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit administrativ.[32]

---

[26]Vendimi nr.44 (86-2021-427), datë 16.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[27]Vendimi nr.66, datë 04.10.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[28]Vendimi nr.310 (86-2021-390), datë 08.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[29]Vendimi nr.411, datë 14.07.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[30]Vendimi nr.34, datë 07.09.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[31]Vendimet nr.44 (86-2021-427), datë 16.06.2021 dhe nr.47 (86-2021-461), datë 24.06.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit
[32]Vendimet nr.67 (86-2021-83), datë 01.02.2021, nr.578, datë 19.11.2021 dhe nr.66, datë 04.10.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit

Në lidhje me aftësinë e gjyqtares për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante *(vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë*, *vendimet e Kolegjit Administrative dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*, *vendimet e Gjykatës Kushtetuese*, *vendimet e GJEDNJ)*, në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.5, datë 30.10.2012 në lidhje me interesin e ligjshëm për ngritjen e padisë;[33]
- vendimin e GJEDNJ "*Agim Beshiri e të tjerë kundër Shqipërisë*", duke analizuar se pas këtij vendimi Këshilli i Ministrave miratoi VKM nr.1114, datë 24.12.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.223, datë 23.03.2016 të Këshillit të Ministrave";[34]
- vendimet e Gjykatës Kushtetuese me nr.9, datë 26.02.2007, nr. 33, datë 24.06.2010 dhe nr.2, datë 18.02.2013, në aspektin e garantimit kushtetues të të drejtave për mbrojtjen shoqërore në përgjithësi dhe e drejta e pensionit në veçanti; vendimi e Gjykatës Kushtetuese me nr.10, datë 04.04.2007, në lidhje me konceptin e shtetit të së drejtës; vendimin unifikues nr.113, datë 22.07.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatëse së Lartë, në lidhje me të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës (*të drejtës së aksesit*); vendimin nr.88, datë 24.06.2021 të Kolegjit Administrative të Gjykatës së Lartë lidhur me parimin e dhënies së ndihmës aktive; vendimin nr.671, datë 03.12.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë lidhur me parashkrim e të drejtës së pensionit;[35]
- vendimet e Gjykatës Kushtetuese me nr.1, datë 16.01.2017, nr. 33, datë 08.06.2016 dhe nr.14, datë 21.03.2014, në drejtim të verifikimit të legjitimimit të organizmave juridikë.[36]

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i përhershëm i gjyqtares që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsyetimit të vendimit. Gjyqtarja referon dhe zbaton:

- *parimin e rezervës ligjore dhe parimin e epërsisë së ligjit*, që në rastin konkret, gjyqtarja argumenton se mbi bazën e këtyre dy parimeve, aktet nënligjore nxirren vetëm nga organet e parashikuara në Kushtetutë, mbi bazën e autorizimit të shprehur në ligj dhe vetëm për çështjet që ligji përcakton se duhen rregulluar me akt nënligjor,[37]
- *parimin procedural të gjykimit administrativ*, sipas të cilit gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktit që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ;[38]
- *parimin e dhënies së ndihmës aktive* , si një nga parimet më të rëndësishme të së drejtës që duhet të udhëheq punën e organeve të administratës publike për përmbushjen e funksioneve të ngarkuara nga ligji, duke interpretuar për këtë qëllim nenin 15/2 të Kushtetutës dhe nenin 10 të Kodit të Procedurës Administrative;[39]

---

[33]Vendimet nr.66, datë 04.10.2021dhe nr.47 (86-2021-461), datë 24.06.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit

[34]Vendimi nr.44 (86-2021-427), datë 16.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[35]Vendimi nr.578, datë 19.11.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[36]Vendimi nr.47 (86-2021-461), datë 24.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[37]Vendimi nr.47 (86-2021-461), datë 24.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[38]Vendimet nr.44 (86-2021-427), datë 16.06.2021, nr.67 (86-2021-83), datë 01.02.2021 dhe nr.578, datë 19.11.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit

[39]Vendimi nr.578, datë 19.11.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

- *parimin e disponibilitetit të padisë* në drejtim të vlerësimit të së drejtës së paditësit për të hequr dorë nga e drejta e padisë;[40]
- referon në Kartën Europiane mbi Statusin e Gjyqtarëve, në të cilën janë sanksionuar parimet e përgjithshme lidhur me çdo vendim që ndikon në përzgjedhjen, rekrutimin, emërimin, përparimin në karrierë ose pushimin e funksioneve të një gjyqtari. Në këtë kontekst gjyqtarja ka analizuar se "*Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit*", miratuar me Rezolutën 40/32, datë 29 nëntor 1985 dhe 40/146, datë 13 dhjetor 1985 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB kanë përcaktuar se mandati i gjyqtarëve, pavarësia, siguria, paga e përshtatshme, kushtet e shërbimit, pensionet dhe mosha e daljes në pension duhet të sigurohen nga ligji në mënyrë të përshtatshme. Gjyqtarja ndalet në mënyrë të veçantë te parimet e sjelljes gjyqësore, të miratuar në vitin 2002 në Bangalore, duke u ndalur në paragrafë të veçantë që normojnë respektimin e rreptë të ligjit nga ana e gjyqtarit, sjelljen personale të një gjykatësi, perceptimin e sjelljes së gjyqtarit nga publiku, etj.[41]

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural, apo në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Po ashtu, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi rezulton kujdesi i shtuar i gjyqtares për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e gjyqtares lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 25 pikë.*

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara, pas termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, duke i bërë të kuptueshëm për lexuesin.

[40]Vendimi nr.310 (86-2021-390), datë 08.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[41]Vendimi nr.66, datë 04.10.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip *(ë dhe ç)*. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe shpesh herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimet në janë të organizuar në nënndarje, të identifikuara me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi*: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 15 pikë.*

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC *(Issue, Rule, Application, Conclusion)*, CRAC *(Conclusion, Rule, Application, Conclusion)* etj., të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet, si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, interpretimin e tij, aplikimin mbi faktet dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Konkretisht, në përmbajtje të vendimeve evidentohet se vendimet gjyqësore përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

- *Konkretisht në mënyrë më specifike konstatohet në çështjet e shqyrtuar mbi bazë ankimi se:*

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, kohën dhe vendin e zhvillimit të gjykimit, identitetin e palëve, disponimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, si dhe shkaqet e ankimit.

Pjesa përshkruese-arsyetuese rezulton që të jetë ndarë në mënyrë të shprehur në disa nën pjesë të titulluara "*Rrethanat e çështjes*", "*Vlerësimi i gjykatës administrative të shkallës së parë*", "dhe "*Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit*" në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Në pjesën e parë të titulluar "*Rrethanat e çështjes*" paraqiten rrethanat e faktit, siç kanë rezultuar të provuara nga shqyrtimi gjyqësor në shkallë të parë apo edhe gjatë gjykimit në apel, në ato raste kur është riçelur pjesërisht hetimi gjyqësor. Në pjesën e dytë të titulluar "*Vlerësimi i gjykatës administrative të shkallës së parë*", gjyqtarja pasqyron disponimin dhe arsyet e vendimmarrjes së gjykatës administrative së shkallës së parë. Në pjesën e tretë të titulluar "*Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit*", gjyqtarja analizon shkurtimisht në lidhje me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, kushtet e pranueshmërisë së ankimit, për të vijuar me vlerësimin dhe arsyet e Gjykatës Administrative të Apelit se pse vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë duhet të ndryshohet apo të lihet në fuqi.

Në pjesën urdhëruese të vendimit referohet baza ligjore procedurale e vendimmarrjes, si dhe disponimi për lënien në fuqi apo për prishjen e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, konform nenit 50 të ligjit nr.49/2012, për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, konform nenit 53 të ligjit nr.49/2012, për çështjet e shqyrtuara në seancë gjyqësore.

- *Në çështjet e shqyrtuar si juridiksionit fillestar në mënyrë më specifike konstatohet se:*

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, kohën dhe vendin e zhvillimit të gjykimit, identitetin e palëve, objektin dhe bazën ligjore të padisë, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

Pjesa përshkruese-arsyetuese rezulton që të jetë ndarë në mënyrë të shprehur në disa nën pjesë të titulluara "*Rrethanat e çështjes*", "*Pretendimet e palëve*", "dhe "*Vlerësimi i Gjykatës*" në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Në pjesën e parë të titulluar "*Rrethanat e çështjes*" paraqiten rrethanat e faktit, të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Në pjesën e dytë të titulluar "*Pretendimet e palëve*", gjyqtarja pasqyron pretendimet dhe prapësimet e palëve në proces. Në pjesën e tretë të titulluar "*Vlerësimi i Gjykatës*", gjyqtarja analizon shkurtimisht në lidhje me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, kushtet e pranueshmërinë e padisë, për të vijuar me vlerësimin dhe

interpretimin e kuadrit ligjor të identifikuar nga gjyqtarja jepen argumenteve ligjore në funksion të konkluzionit të gjykatës mbi pranimin apo rrëzimin e padisë.
Në pjesën urdhëruese të vendimit referohet baza ligjore procedurale e vendimmarrjes, si dhe disponimi për rrëzimin apo pranimin e padisë, si dhe disponimi për shpenzimet gjyqësore dhe të drejtën e ankimit.

KONKLUZIONI
Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 10 pikë.*

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjyqtarëve u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, për sa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t'u ankuar.[42]

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se vendimet gjyqësore dominohen nga proces analitik dhe vlerësues në raport me atë përshkrues të fakteve dhe provave. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila në vendimet gjyqësore burim vlerësimi është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë e saj provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni mbi provueshmërinë e fakteve konkrete.

Në vendimet burim vlerësimi, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, analiza e faktit dhe ajo ligjore, zhvillohen në mënyrë logjike, duke paraqitur argumente për secilin pretendim dhe kërkim të palëve ndërgjyqëse *(në çështjet e shqyrtuar si juridiksion fillestar)* dhe për secilin shkak ankimi *(në çështjet e shqyrtuar mbi bazë ankimi).* Norma ligjore zbërthehet sipas qëllimit, duke i dhënë përgjigje shkakut konkret të ngritur në padi apo në ankim, pa zgjatje dhe konfuzion, në rrjedhë logjike me konkluzionin e arritur.

Argumentet ndjekin një linjë arsyetimi e cila zhvillohet në mënyrë dinamike mbi çdo fakt apo çështje të marrë në analizë, duke mbështetur në mënyrë logjike konkluzionin e arritur. Gjyqtarja tregon kujdes për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore të

[42]Vendimi i GJEDNJ, çështja "*Hadjanastassiou kundër Greqisë*".

zbatueshme në çështjen konkrete, nëpërmjet një analizë dhe interpretimi individual lidhur me kuptimin e tyre, duke i mbështetur më pas ato edhe me qëndrime të praktikes gjyqësore kur është vlerësuar e nevojshme. Në mënyrë konkrete, në disa nga vendimet burim vlerësimi, ka rezultuar se gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi të posaçme analizës abstrakte të instituteve, parimeve apo normave ligjore, para aplikimit të tyre mbi faktet konkrete, si p.sh.:

(i) Duke interpretuar legjislacion e zbatueshëm në çështjen objekt gjykimi gjyqtarja analizon në mënyrë të detajuar *institutin e pezullimit nga detyra të magjistratit*. Në këtë kontekst gjyqtarja pasqyron se deri para ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 ky institut procedural nuk njihej në kuadër të procedimit disiplinor të gjyqtarëve. Me ndryshimet kushtetuese u sanksionua instituti i pezullimit nga detyra të magjistratit duke parashikuar rregullime të veçanta në nenin 140 pika 3 të Kushtetutës dhe më në nenin 152 të ligjit nr.96/2016 *(dispozitë e shfuqizuar më pas me vendimin nr.34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe e ndryshuar kjo dispozitë me ligjin nr.48/2019 dhe ligjin nr.15/2020*); [43]

(ii) analizon gjerësisht konceptin e *të drejtës për pension* në kuadër të legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar. Interpreton ligjin nr.8098, datë 28.03.1996 "*Për statusin e të verbërve*" në funksion të analizës së subjekteve të këtij ligji, fushës së zbatimit, formave të paaftësisë, të ardhurat e përfituara nga subjektet e këtij ligji, formën dhe mënyrën e përfitimit të këtyre të ardhurave nga organet përkatëse etj. Gjyqtarja duke interpretuar nenet 1-4, 7, 1120, 23 të ligjit nr.9335/2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, jep konsiderata juridike lidhur me qëllimin e ligjit, parimet bazë mbi të cilat funksionon skema e ndihmës dhe e shërbimeve shoqërore, përkufizimet, përfituesit e pagesës për aftësinë e kufizuar, formën e pagesës dhe ndihmës ekonomike;[44]

(iii) analizon natyrën referuese dhe plotësuese të ligjit nr.49/2012, duke vlerësuar se përsa në këtë ligj nuk është ka një parashikim në se çfarë ndodh me gjykimin në Gjykatën Administrative të Apelit kur paditësi heq dorë nga e drejta e padisë, gjykata i referohet K.Pr.Civile. Duke vlerësuar rrethanat e çështjes gjykata ka analizuar *institutin e heqjes dorë nga padia* duke analizuar se e drejta e heqjes dorë nga e drejta e padisë është një e drejtë disponimi mbi themelin e të drejtës së pretenduar në një gjykim;[45]

(iv) analizon kriteret ligjore të sigurimit të padisë duke argumentuar se për vendosjen e masave të sigurimit gjykata duhet të vlerësojë detyrimisht ekzistencën e kushteve kumulative të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova lidhur me mundësinë e shkaktimit të dëmit të rëndë, dëmi i rëndë të jetë i pakthyeshëm, të jetë i atëçastshëm, ruajtja e interesit të publikut si dhe garancia e paditësit lidhur me dëmin që mund të vij nga sigurimi i padisë. Analizon masën e sigurimit "*pezullimin e zbatimit të veprimit administrativ*". Në këtë aspekt gjyqtarja analizon se si rregull masa e sigurimit tipike që merret në gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative është ajo e "*pezullimit të zbatimit të veprimit administrativ*". Përjashtimisht ligji nr.49/2012 ka lejuar marrjen e masave të tjera kur sipas rrethanave të çështjes pezullimi i aktit administrativ nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme në lidhje me sigurimin e efektivitetit dhe dobishmërisë së procesit gjyqësor që do të realizohet mes palëve;[46]

(v) Analizon konceptin e *njoftimit si dhe format e tij* lidhur me komunikimin e organit publik me palën apo subjektet e interesuara, të përfshira në një procedurë administrative. Gjithashtu gjyqtarja analizon konceptin e veprimit administrativ apo procedural me anë të njoftimit, si dhe format e tij. Analizon në mënyrë të detajuar procedurën e plotë që ligji nr.133/2015 dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij

---

[43]Vendimi nr.66, datë 04.10.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[44]Vendim nr.578, datë 19.11.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[45]Vendimi nr. 310(86-2021-390), datë 08.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit
[46]Vendimi nr.34, datë 07.09.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

kanë parashikuar lidhur me trajtimin e pronës, përfundimin e procesit të kompensimit të pronave, si dhe mënyrën e disponimit nga organet publike të ngarkuara me zbatimin e këtyre procedurave. Analizon të *drejtën e pronës* si një të drejtë të njohur dhe garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, KEDNJ dhe ligji.[47]

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor. Në çështjet me juridiksion fillestar shpjegimet dhe prapësimet e palëve parashtrohen fillimisht në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsyetimit, ndërsa më pas merren në analizë më vete, të ndërthurura më analizën e provave dhe zbatimin e ligjit. Në çështjet e shqyrtuar mbi bazë ankimi, shkaqet e ankimit merren në analizë nga ana e gjyqtares dhe ju jepet në çdo rast përgjigje e argumentuar në aspektin e mbështetjes në ligj apo prova të tyre.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin "Cilësia e analizës dhe argumentit logjik". Gjyqtarja analizon në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet e çështjesh, për të vijuar me analizën e koncepteve ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes, mbi bazën e një zhvillimi dhe argumentimi logjik mbi mënyrën e aplikimit të tyre mbi rastin në shqyrtim. Gjyqtarja e zhvillon argumentimin e saj duke ndjekur logjikën e zhvillimit e marrëdhënies shkak-pasojë, si dhe duke u kujdesur për të marrë në analizë dhe për t'i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, duke përmbushur të standardin e procesit të rregullt ligjor.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 25 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {…} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

[47]Vendimi nr. 44 (86-2021-427), datë 16.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

2.A Aftësia e gjyqtares për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Në nenin 48 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar parashikohet se: "...*Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi…".* Në nenin 51 të ligjit nr.49/2012 parashikohet se: *"Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. 2. Vendimi i mësipërm, data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve rregullisht nga sekretaria gjyqësore, të paktën 10 ditë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore.*

Në referim të dispozitave të mësipërme çështjet që janë shqyrtuar në dhomë këshillimi do të llogariten me afat ligjor 30 ditor, në kuptim të nenit 48 të ligjit, ndërsa çështjet të cilat janë shqyrtuar në seancë gjyqësore *(në mungesë të një afati të posaçëm)* do të llogariten me afat standard minimal, duke iu referuar afatit standard minimal për shqyrtimin e çështjeve në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, afat i parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2 datë 14.04.2010 të KLD, në të cilën përcaktohet se: *"Standardi kohor i punës nënkupton realizimin e nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si më poshtë:... c) Gjykimet civile në gjykatën e apelit, jo më tej se 6 muaj".*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar 80 çështje, për të cilat ligji parashikon afat ligjor dhe 74 çështje me afat standard minimal. Duke i ndarë sipas kategorive, çështjet e gjykuara tej afatit ligjor, rezultojnë si më poshtë:

(i) 57 çështje të kategorisë "*Çështje me palë kundërshtare*" të shqyrtuar në dhomë këshillimi, kanë përfunduar jashtë afatit ligjor (30 ditë) të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012, i ndryshuar. Koha e gjykimit të tyre varion nga 36 ditë deri në 3 vjet e 9 muaj, me një mesatare vonese prej 360 ditë nga afati 30/ditor i parashikuar në ligjin 49/2012.

(ii) 8 çështje nga kategoria "*Çështje pa palë kundërshtare*", me objekt "*Sigurim padi*", "*Pezullim akti apo pezullim veprimesh përmbarimore"* dhe *"Shkelje afati gjykimi",* kanë përfunduar jashtë afatit ligjor, të parashikuar nga neni 28 i ligjit 49/2012 (lidhur me kërkesat objekt sigurim padie)[48] dhe neni 399/7 i K.Pr.Civile (lidhur me kërkesat me objekt shkelje afati gjykimi).[49]

[48]Neni 28 i ligjit nr.49/2012, parashikon se: "Kërkesa për sigurimin e padisë, sipas pikave 1 dhe 2 këtij neni, duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në raste të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët. 4.Vendimi për sigurimin e padisë jepet në çdo fazë dhe shkallë të shqyrtimit gjyqësor, derisa vendimi nuk ka marrë formë të prerë."

Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se çështjet me numër rendor 5, 7 dhe 9 ka përfunduar për 6 ditë, duke e tejkaluar afatin ligjor vetëm me 1 ditë, tejkalim i cili vlerësohet të jetë i papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përllogaritjen e afatit. Sa më sipër, për efekt të kësaj kategorie do të konsiderohen të shqyrtuara tej afatit vetëm 5 çështje. Koha e gjykimit të tyre varion nga 10 ditë deri në 211 ditë, me një mesatare vonese prej 94 ditë, nga afati 5 ditor i parashikuar në nenin 28 të ligjit 49/2012 dhe nga afati 45 ditor i parashikuar nga nenin 399/7 i K.Pr.Civile.

(iii) 13 çështje të kategorisë "*Marrëdhënie pune*", të shqyrtuar në dhomë këshillimi, kanë përfunduar jashtë afatit ligjor (30 ditë) të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012, i ndryshuar. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se çështjet me numër rendor 8 dhe 9 ka përfunduar për 36 ditë, duke e tejkaluar afatin ligjor vetëm me 6 ditë, tejkalim ky që konsiderohet i papërfillshëm, duke pasur parasysh këtu edhe ngarkesën e gjykatës, si dhe organizmin e saj në trupa gjyqësore. Sa më sipër, për efekt të kësaj kategorie do të konsiderohen të shqyrtuara tej afatit 11 çështje. Koha e gjykimit të tyre varion nga 145 ditë deri në 2 vjet e 11 muaj, me një mesatare vonese prej 307 ditë nga afati 30/ditor i parashikuar në ligjin 49/2012.

Sa më sipër, në total nga 80 çështje gjithsej të cilat kanë të parashikuar afat ligjor për përfundimin e tyre (duke zbritur çështjet e sipërcituara), rezulton që gjyqtarja **ka përfunduar jashtë afatit ligjor 73 çështje ose 91% të çështjeve** që parashikojnë afat ligjor për përfundimin e tyre, e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 3 pikë.

Gjyqtarja dhe zv.kryetarja e gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit e kanë vlerësuar ketë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar se ngarkesa e çështjeve për gjykim gjatë vitit 2021 është shumë e lartë, krahasuar me numrin e gjyqtarëve që në vitin 2021 pësoi një ulje të ndjeshme për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, ku në fund të vitit 2021 mbetën vetëm 5 gjyqtarë efektivë, fakt që diktoi vështirësi të dukshme në organizmin e punës në trupa gjyqësor me tre dhe pesë gjyqtarë. Lidhur me kompleksitetin e çështjeve, një rëndësi të veçantë në gjykimin në apelin administrative, ka gjykimi i akteve nënligjore, që për nga rëndësia, i është besuar gjykimit të trupës gjyqësore të përbërë nga 5 gjyqtarë. Ky lloj gjykimi është i ngjashëm më gjykimin kushtetuese, pasi edhe Gjykata Administrative e Apelit bën kontroll abstrakt të normave nga pikëpamja e ligjshmërisë, arsyetim i cili kërkon kohë, përkushtim, pjekuri dhe nivel të lartë profesionale. Zv.kryetarja e gjykatës thekson ndër të tjera edhe faktin gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në respektimin e afateve të parashikuara nga ligji në gjykimin e çështjeve. Në pjesën më të madhe, shkaqet e shtyrjes së seancave apo të tjera që kanë ndikuar në afatin e gjykimit nuk lidhen me gjyqtaren por me elementë që lidhen me palët, të drejtën për mbrojtje efektive, proces të rregullt ligjor etj. Gjithashtu sjell në vëmendje se backlog-u i krijuar për shkak të mungesës së gjyqtarëve, dikur 13 gjyqtar dhe deri në fund të vitit mbetën 6 gjyqtar. E gjitha kjo situatë ka bërë që gjyqtarja të ngarkohet me shumë seç parashikon ligji. Po kështu zv.kryetarja parashtron se referuar natyrë së çështjeve që gjykohen pranë kësaj gjykate, janë shtuar si gjykime juridiksioni fillestar, akët nënligjore (gjykimet me KED, KLGJ, KLP, etj.) gjykime këto të cilat për nga natyra e çështjes dhe afatet ligjore duhet t'i jepet më shumë përparësi se çështjet e tjera të regjistruara në gjykatë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja në kundërshtimet e saj ka kërkuar pikëzimin maksimal me 15 pikë, duke parashtruar disa rrethana objektive të pavarura prej saj, që kanë ndikuar në

[49]Neni 399/7 i K.Pr.Civile parashikon se: "Gjykimi i kërkesës, sipas nenit 399/6, pika 1, bëhet në dhomë këshillimi dhe gjykata që shqyrton çështjen merr vendim brenda 45 ditëve, nga paraqitja e kërkesë."

kriterin e aftësisë për të përballuar ngarkesën e punës. Argumentet e parashtruara nga gjyqtarja afektojnë të gjithë treguesit e kriterit "Aftësisë organizative" dhe për këtë arsye do të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në këtë pjesë, për tu mos u përsëritur në treguesi e tjerë në vijim. Në kundërshtimet e paraqitura lidhur me projektraportin e vlerësimit gjyqtarja parashtron këto argumente:

1. Numri i lartë çështjeve gjyqësore në raport me numrin e ulët të gjyqtarëve *duke u ndaluar në (i) përballimin i një ngarkese të lartë çështjesh ndër vite me një organikë të përbërë vetëm prej 7 gjyqtarësh, duke mos pasur një raport të drejtë midis treguesve për numrin e gjyqtarëve dhe volumit të ngarkesës midis gjykatave administrative dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, (ii) shtim i parapritur i numrit të çështjeve si rezultat i vendimit unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 6.12.2013, edhe në vitet në vijim me efekt zinxhir nga vitet paraardhëse, megjithë ngarkesën e evaduar të çështjeve duke pasur një numër shumë të lartë çështjesh në raport me numrin e pamjaftueshëm të gjyqtarëve në organikën e saj, në vitin 2020 kanë ushtruar detyrën 9 gjyqtarë nga 13 që parashikohet në organikë; (iii) Të dhënave statistikore për vitin 2021, referuar Analizës Vjetore të Gjykatës Administrative të Apelit për vitin 2021, ku rezulton se ngarkesa me çështje gjyqësore është shumë e lartë në raport me numrin e trupës gjykues prej 5 gjyqtar. Monitorimi i afateve kohore nuk duhet të kufizohet në mbledhjen e të dhënave në lidhje me afatet kohore totale ndërmjet fillimit dhe përfundimit të proceseve gjyqësore, por duhet të vlerësohet gjithashtu informacion mbi kohëzgjatjen e fazave të ndërmjetme të procesit dhe shkaqeve objektive që mund ta kenë cënuar këtë proces.*
2. Ndikimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve në shtimin e papritur të ngarkesës me çështje gjyqësore dhe përballimin e ngarkesës në punë, *duke pasqyruar ndikimin e këtij procesi gjatë vitit 2021, përgjatë së cilës janë shkarkuar edhe katër gjyqtarë të kësaj gjykate dhe detajimin në mënyrë këtë kronologji kohore rishortimet* e *çështjeve të gjyqtarëve të shkarkuar, mes të gjithë anëtarëve të trupës gjyqësore të mbetur. Në këto kushte, në këtë situatë jo të zakontë pune, planifikimi i seancave gjyqësore dhe i dhomave të këshillimit në Gjykatën Administrative të Apelit, nuk ishte më përgjegjësi e ekskluzive e gjyqtarit relator, por ajo ishte e lidhur ngushtësisht me mundësinë e anëtarëve të tjerë të trupës gjyqësore për t'u angazhuar në planifikimet e pritshme dhe për pjesëmarrjen në gjykimet e çështjeve*.
3. Ndikimi i Pandemisë Covid-19;
4. Aplikim i gabuar i metodologjisë sipas vendimit të KLD nr. 261/2, datë 14.04.2010 "Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve", duke argumentuar se *ky akt nënligjor i hartuar në vitin 2010 nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk duhet të gjejë zbatim në vlerësimin tim, për shkak se ky akt është hartuar në një kohë kur gjykatat administrative ende nuk ishin krijuar. Ky akt i përgjigjet një situate tjetër në sistemin gjyqësor kur numri i gjyqtarëve dhe ngarkesa e çështjeve për gjykim ishte normale. Në këtë situatë minimalisht, meqë ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat për përfundimin e gjykimit si shkallë e parë, referenca ligjore duhet të jetë afati 1(një) vjeçar i parashikuar nga neni 399 i Kodit të Procedurës Civile.*

Po kështu, në sqarimet plotësuese të depozituara nëpërmjet postes elektronike në datën 10.10.2022 gjyqtarja parashtron:

5. Kundërshtimet në lidhje me 6 (gjashtë) çështjes gjyqësore të përzgjedhura me short, duke *u ndaluar në ecurinë procedurale të tyre, si dhe duke saktësuar datën e dorëzimit të këtyre vendimeve*;
6. Disa aspekte të procedurës specifike të gjykimit në apelit administrativ me ndikim në kohëzgjatjen e gjykimeve konkrete, *duke u ndaluar tek shtyrja e dhomës së këshillimit për shkak të plotësimit të të metave të ankimit dhe njoftimin e ankimit të plotësuar palëve të tjera ndërgjyqëse sipas praktikës së Kolegjit Administrative të Gjykatës së Latë, çështjet me kalim procedural në dhomë këshillimi sipas praktikës së Kolegjit Administrative të Gjykatës së Lartë, çështjet që gjykohen si gjykatë e shkallës së parë,*

rrethana që kërkon të merren parasysh në vlerësimin në drejtim të aftësive për të përballuar ngarkesën e punës në vitin 2021, për të shmangur përfundime që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Argumentet e parashtruar nga gjyqtarja lidhur me ngarkesën e lartë të çështjesh ndër vite, që prej vitit 2013 e në vijim, apo shtim i parapritur i numrit të çështjeve si rezultat i vendimit unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 6.12.2013, janë marrë parasysh dhe janë vlerësuar nga Këshilli në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares për periudhën 2013-2016, pasi vendimi unifikues nr.3/2013 ka sjell rritje të papritur të volumit të punës, gjatë vitit 2014, dhe ky vendim nuk afekton vlerësimin e vitit 2021. Lidhur me argumentet për ndikimin e Pandemisë Covid-19 apo aplikimi i gabuar i metodologjisë sipas vendimit të KLD nr.261/2, datë 14.04.2010, janë argumentet të cilat afektojnë treguesin "Plotësimi i standardeve minimale kohore". Nga analiza e të dhënave statistikore nuk rezulton në asnjë rast që tejkalimi i afateve ligjore të ketë ardhur si pasoj e ndikimit të pandemisë, pasi tejkalimi i afateve ligjore shkon në disa raste deri në 3 vjet.

Lidhur me pretendimin e gjyqtares se tejkalimi i afatit 7 ditor për kryerjen e veprimeve përgatitore në çështjen administrative me nr.44 (86-2021-427), datë 16.06.2021 ka ardhur si pasoje e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të Pandemisë Covid-19, evidentohet se kjo çështje është çështje e juridiksionit fillestar, dhe si e tillë është konsideruar çështje me standard minimal kohor, dhe nuk ndikon në treguesin e "Respektimi i afateve ligjore". Shkak i tejkalimit të afatit 7 ditor të përcaktuar në nenin 25 të ligjit 49/2012, i ndryshuar, afekton në treguesin "Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor", tregues ky i vlerësuar në nivelin maksimal.

KONKLUZIONI

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Në përcaktimin e nivelit të pikëzimit konsiderohen në rastin konkret:

i) ngarkesa e gjyqtares si relatore dhe anëtare (në total ka gjykuar 154 çështje si relatore dhe 296 çështje si anëtare);

ii) mendimi i zv.kryetares dhe vetëvlerësimi i gjyqtares lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;

iii) numri i lartë i çështjeve me afat ligjor ku gjyqtarja ka qenë relatore pasi rezulton se ka përfunduar 80 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë 52% të çështjeve të shqyrtuara prej saj në vitin 2021;

iv) si dhe duke pasur në vëmendje se caktimi i datës dhe orës së gjykimit të çështjes së ardhur mbi ankim të palës/palëve, bëhet nga gjyqtari relator, në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit.

Sa më sipër, gjyqtarja vlerësohet dy nivele më lartë se pikëzimi që rezulton nga të dhënat statistikore. Gjyqtarja nuk mund të pikëzohet maksimalisht, pasi pavarësisht ekzistencës së rrethanave objektive të pasqyruara nga ana e gjyqtares në formalin e integruar, apo në kundërshtimet e saj, gjyqtarja duhet t'i kushte kushtuar një rëndësi të veçantë dhe parësor çështjeve me afat ligjor, të cilat për shkak të rëndësisë së tyre duhet të gjykohen jo brenda afateve të arsyeshme, por brenda afateve të përcaktuara shprehimisht në ligj.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi**: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin "Respektimi i afateve ligjore", gjyqtarja vlerësohet në nivelin "21-30%", pikëzuar me 9 pikë.*

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Sikurse u analizua edhe në treguesin e mësipërm, çështjet gjyqësore të shqyrtuara në seancë gjyqësore do të llogariten si çështje me standard minimal kohor. Po kështu, edhe çështjet e juridiksionit fillestar, do të konsiderohen çështje me standard minimal kohor, në kushtet kur këto çështje gjykohen në bazë të kompetencës funksionale të gjykatës, duke e gjykuar si gjykatë e shkallës së parë.

Plotësimi i standardeve minimale kohore nënkupton respektimin nga ana e gjyqtarit të afateve orientuese, për çdo kategori çështjes, të përcaktuar në vendimin nr.261/2, datë 14.4.2010, të KLD, ende në fuqi. Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësimi bëhet referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të gjykuara. Në vendimin nr.261/2, datë 14.04.2010 ku përcaktohen kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore, nuk rezulton të jetë përcaktuar standardi minimal kohor për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e apelit, por rezulton që për gjykatat e apeli të jetë përcaktuar standardi minimal kohor vetëm për gjykimet civile, duke u përcaktuar ky afat, jo më tej se 6 muaj.

Lidhur me zbatimin e këtij vendimi, gjyqtarja ka parashtruar se aplikimi i këtij akti nënligjor, është i gabuar dhe nuk duhet të gjejë zbatim në vlerësim, për shkak se ky akt është hartuar në një kohë kur gjykatat administrative ende nuk ishin krijuar, por për sa kohë që ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat për përfundimin e gjykimit si shkallë e parë, referenca ligjore duhet të jetë afati 1(një) vjeçar i parashikuar nga neni 399 i Kodit të Procedurës Civile.

Është e vërtet që vendimi nr.261/2, datë 14.04.2010 nuk parashikon afate orientuese për gjykimin e çështjeve administrative për gjykatën e apelit, por në ky vendim parashikon afate orientuese për gjykimin e çështjeve administrative në shkallë të parë dhe pikërisht në pikën 5, shkronja "c" parashikohet se "*Gjykimet e mosmarrëveshje administrative në gjykatën e shkallës së parë, jo me tej se 1 muaj*". Pavarësisht këtij parashikimi, në raportin e vlerësimit referimi lidhur me standardet minimale kohore është bërë sipas pikës 5, shkronja "h", kjo duke pasur parasysh specifiken e gjykimeve administrative në gjykatën e apelit, po kështu edhe duke pasur parasysh qëndrimin e Këshillit në vlerësimet e mëparshëm, për të gjithë gjyqtarët, përfshitë këtu edhe gjyqtaren {…} e cila është vlerësuar për periudhën 2013-2016, dhe për këtë periudhe nuk rezulton të ketë kundërshtuar aplikimin e këtij vendimi.

Lidhur me pretendimin për aplikimin si referencë ligjore të nenit 399/2 pika 1, shkronja "a" i K.Pr.Civile, vlerësohet se kjo referencë ligjore nuk mund të aplikohet si afat orientues, sikurse përcaktohet në metodologjinë e pikëzimit, por ka lidhje me afatin e arsyeshëm për përfundimin e gjykimit dhe me të drejtën që pala ka për t'ju drejtuar gjykatës me kërkesë për shpërblimin e drejtë të personit që ka pësuar një dëm pasuror ose jopasuror, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas përkufizimit të nenit 6/1 të Konventës Europiane "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore".

Afati i përfundimit të gjykimit për gjykatën administrative të apelit, për çështjet për të cilat nuk ka afat ligjor gjykimi, është konsideruar periudha kohore nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim nga gjyqtari relator deri në datën e shpalljes së vendimit, në referim kjo të Udhëzuesit "Për plotësimin e tabelave me të dhënat statistikore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve", miratuar me vendimin nr.60, datë 30.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, me përjashtim të:

(i) 13 çështje tek tabela nr.1, kategoria "*Çështje me palë kundërshtare*", dhe konkretisht çështjet me numër 5, 12, 13, 19, 20, 23, 24, 28, 32, 33, 41, 42 dhe 87 rendor, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

(ii) 2 çështje tek tabela nr.3, kategoria "*Marrëdhënie pune*", dhe konkretisht çështjet me nr.1 dhe 15 rendor kanë përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se çështja me numër rendor 15, ka përfunduar për 6 muaj e 3 ditë, duke tejkaluar me vetëm 3 ditë standardin minimal kohor, tejkalim ky qe konsiderohet i papërfillshëm. Sa më sipër, për efekt të kësaj kategorie do të konsiderohen të shqyrtuara tej afatit vetëm 1 çështje. Koha e gjykimit të cilës është 1 vit 3 muaj e 2 ditë.

(iii) 4 çështje tek tabela nr.4, kategoria e çështjeve "*Juridiksion fillestar*", dhe konkretisht çështjet me nr. 1, 4, 8 dhe 15 rendor kanë përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 të, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se çështjet me numër rendor 1 ka përfunduar për 6 muaj e 18 ditë, nëse në afatin e gjykimit nuk do të përfshihej periudha e lejes vjetore *(muaj gusht)*, atëherë çështja do të kishe përfunduar brenda afatit 6 mujor. Sa më sipër, për efekt të kësaj kategorie do të konsiderohen të shqyrtuara tej afatit 3 çështje.

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (17 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi (74 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar ***rreth 22.9 % të çështjeve në tejkalim të standardit minimal kohor***.

Gjyqtarja dhe zv.kryetarja e gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit e kanë vlerësuar ketë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar se në këtë kriter duhet të mbahet në konsideratë fakti se asnjëherë personalisht nuk është bërë shkak për zvarritjen ose shtyrjen e seancave. Po kështu, kompleksiteti i çështjeve është një element tjetër që ndikon në kohën që i duhet gjyqtarit për të vendosur në lidhje me çështjen. Në lidhje me kohëzgjatjen e një procesi ndikon natyra e çështjes kërkesat e palëve për të marrë në shqyrtim prova të tjera, nevoja e kalimit të çështjeve në seancë gjyqësore për të qartësuar rrethanat e faktit, marrjes së provave të nevojshme, rëndësisë së dëgjimit të palëve dhe ekspertëve në seancë gjyqësore, patur parasysh se gjykata e apelit pavarësisht funksionit rishikues është edhe gjykatë fakti. Me efekt procedural në pamundësinë e respektimit të afateve të gjykimit, është edhe lënia

kohë palës ankuese për të plotësuar të metat e ankimit, për shkak të praktikës së konsoliduar të Kolegjit Administrative të Gjykatës së Lartë, të reflektuar edhe në ndryshimet që pësoi ligji nr.49/2012 në vitin 2021.

KONKLUZIONI

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe analizës së mësipërme lidhur me afatin e gjykimit të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 22.9%, pavarësisht ngarkesës në punë, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes për përfundimin e gjykimit në 77% të tyre duke respektuar standardin minimal kohor. Nga ana tjetër, në vlerësimin e këtij treguesi, vlen të mbahet parasysh se në afatin e gjykimit të disa[50] çështjeve ka ndikuar edhe periudha në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar, për shkak të vendimeve nr. 127, datë 10.03.2020, "*Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë*", nr. 128, datë 24.03.2020 *"Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë"*, nr.133, datë 06.04.2020 *"Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë"* të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020 "*Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19*", miratuar me ligjin nr.30/2020. Nga ana tjetër në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, gjyqtarja ka përfunduar për vitin 2021, në total 154 çështje, ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 200 çështje në vit, ngarkesë pune që nuk justifikon pikëzim maksimal të gjyqtares për këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi**: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin "Plotësimi i standardeve minimale kohore" gjyqtarja vlerësohet në nivelin "Mbi 10-20%", duke u pikëzuar me 4 pikë.*

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar për gjysmën e kategorive të çështjeve. Konkretisht,

- Në kategorinë "Çështje me palë kundërshtare", koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 252 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muaj, duke e llogaritur këtë afat nga data e nxjerrës për gjykim.

[50]Në tabelën nr.1, çështja me nr. rendor 5 është nxjerr për gjykim në datën 12.02.2020, çështja me nr. rendor 12 është nxjerr për gjykim në datën 01.04.2020, çështja me nr. rendor 13 është nxjerr për gjykim në datën 12.12.2019, çështja me nr. rendor 19 është nxjerr për gjykim në datën 24.02.2020, çështja me nr. rendor 23 është nxjerr për gjykim në datën 16.01.2020, çështja me nr. rendor 24 është nxjerr për gjykim në datën 24.02.2020, çështja me nr. rendor 28 është nxjerr për gjykim në datën 24.02.2020, çështja me nr. rendor 33 është nxjerr për gjykim në datën 24.02.2020, çështja me nr. rendor 42 është nxjerr për gjykim në datën 01.04.2020.

- Në kategorinë "Çështje pa palë kundërshtare", koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 4.5 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 4 muaj, duke e llogaritur këtë afat nga data e nxjerrës për gjykim.
- Në kategorinë e çështjeve "Marrëdhënie pune", koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, është 209 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muaj, duke e llogaritur këtë afat nga data e nxjerrës për gjykim.
- Në kategorinë e çështjeve "Juridiksion fillestar", koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, është 176 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muaj, duke e llogaritur këtë afat nga data e nxjerrës për gjykim.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetarja e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke renditur si shkak që ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve natyrën e çështjeve, faktin se gjykimi në gjykatën e apelit zhvillohet me tre dhe pesë gjyqtarë dhe caktimi i datës së seancave gjyqësore ose vendimi i pranimit të kërkesave për shtyrje nga palët nuk mbetet më përgjegjësi e gjyqtarit relator, pasi çdo vendim merret në kolegjialitet.

KONKLUZIONI

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 3 pikësh. Por duke marrë në konsideratë volumin e çështjeve, specifikat e gjykimit në apelin administrativ në lidhje me organizimin e punës për shkak se gjykimi zhvillohet me trup gjykues të përbërë nga tre dhe pesë gjyqtarë, si dhe faktin se përgjithësisht gjyqtarja ka treguar kujdes për zhvillimin e gjykimit brenda afateve, gjyqtarja vlerësohet një nivel më të lartë pikëzimi, duke u vlerësuar me 4 pikë, por jo në nivelin maksimal të tij, në kushtet kur numri i çështjeve të përfunduar gjatë vitit 2021, nuk justifikon vlerësimin maksimal të gjyqtares për këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues vlerësohet "Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve", duke e pikëzuar me 4 pikë.*

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara si relatore (154), me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik 2021 (790) është 19.49%.

Në formularin e integruar të vlerësimit, gjyqtarja dhe zv.kryetarja e gjykatës kanë parashtruar se gjyqtarja ka nivel të lartë të rendimentit, duke evidentuar se ngarkesa në punë gjatë vitit 2021 ka qenë shumë e lartë, për shkak të problematikës që shkaktoi largimi i disa gjyqtarëve në këtë vit për shkak të procesit të vettingut dhe angazhimit të trupës gjyqësore me proceset në vijim të planifikuara prej tyre.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme (19.49%) pikëzohet me 2 pikë. Referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, pikëzimi për këtë tregues bëhet duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, duke shmangur çështje që

nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Mbi këtë bazë, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarit. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës, i përcaktuar për gjyqtarin e gjykatës së apelit dhoma civile. Në rastin konkret nuk rezulton që gjyqtarja të ketë gjykuar më shumë se standardi minimal i punës, pasi gjyqtarja gjatë vitit 2021 ka përfunduar në total 154 çështje si relator, *nga 200 çështje të përcaktuar për g*jyqtarin e gjykatës së apelit dhoma civile.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësuar në tërësinë e tyre, si dhe të dhënave statistikore nga të cilat rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjatë gjithë vitit 2021, 154 çështje si relatore, *(nga të cilat 122 çështje janë me palë kundërshtare*), pra duke mos e tejkaluar më shumë se 50% treguesin sasior në fuqi sipas "Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore" miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD, por nga ana tjetër duke pasur parasysh edhe ngarkesën e saj si anëtare *(ka përfunduar 296 çështje në këtë cilësi)* rendimenti i përfundimit të çështjeve nga gjyqtarja, pavarësisht se rezulton të jetë 19.49%, vlerësohet dy nivele më lartë se ajo që i përket përqindjes së pikëzimit referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pasi shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtares lidhen me organizmin e gjykatës në trupa gjyqësore me tre dhe pesë gjyqtarë dhe problematikave të lindura për shkak të largimit të gjyqtarëve për shkak të procesit të vettingut.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi*: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, pavarësisht se rendimenti i përfundimit të çështjeve është 19.49%, ky tregues pikëzohet me 6 pikë.*

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin ligjor 7 ditor të parashikuar në nenin 55 të ligjit nr. 49/2012, është si më poshtë:

- Në kategorinë "Çështje me palë kundërshtare" koha mesatare e arsyetimit është 18.4 ditë, ***pra më e gjatë*** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.
- Në kategorinë "Çështje pa palë kundërshtare" koha mesatare e arsyetimit është 20.3 ditë, ***pra më e gjatë*** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.
- Në kategorinë e çështjeve "Marrëdhënie pune" koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 15.4 ditë, ***pra më e gjatë*** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.
- Në kategorinë e çështjeve "Juridiksion fillestar" koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 55 ditë, ***pra më e gjatë*** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka parashtruar se shumica e vendimeve të saj janë arsyetuar brenda afatit ligjor. Gjithashtu ajo parashtron se në kohën e arsyetimit të vendimit duhet të merret në konsideratë ngarkesa dhe numri i lartë i çështjeve, koha fizike që merr studimi dhe gjykimi, kompleksiteti që ka gjykimi administrativ, dinamika e vazhdueshme e ndryshimeve në legjislacion, kuadri ligjor shumë i gjerë që gjen zbatim. Po kështu, kohë në arsyetim të vendimet merr edhe fakti se për shkak të ngarkesës në punë, orari zyrtar i punës është shfrytëzuar për zhvillimin e seancave, ndërsa arsyetimi i vendimeve është realizuar përtej orarit zyrtar. Një tjetër tregues që ka ndikuar në kohën e arsyetimit të vendimit është fakti që disa prej vendimeve janë marrë me shumicën e votave të anëtarëve të trupës gjyqësore dhe në datën e dorëzimit ka ndikuar fakti i arsyetimit të pakicës së vendimit nga gjyqtari respektiv. Të njëjtat shkaqe të përgjithshme që diktojnë kohën e arsyetimit të vendimeve parashtrohen edhe nga zv.kryetarja e gjykatës lidhur me këtë tregues.

Nga ana tjetër, afati 7 ditor i arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar i përcaktuar në nenin 55 të ligjit nr. 49/2012, është shumë më i shkurtër krahasuar me afatin 20 ditor të arsyetimit të vendimeve gjyqësore civile sipas parashikimeve të nenit 308 paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile (pas ndryshimeve me ligjin nr.38/2017, datë 30.03.2017). Edhe pse ligji nr.49/2012 përbën ligj të posaçëm dhe sipas nenit 1 pika 2 të tij, dispozitat e K.Pr.Civile zbatohen vetëm në rastet kur nuk parashikohet ndryshe në të, përsëri duket se pas ndryshimeve të K.Pr.Civile dhe shkaqeve që kanë çuar ligjvënësin në përcaktimin e afatit 20 ditor të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ka një mungesë harmonizimi mes qëllimit të parashikimit të këtij afati me afatin e arsyetimit të parashikuar në ligjin nr.49/2012.

Referuar akteve të depozituar prej gjyqtares (kopje e regjistrit të dorëzimit të vendimeve) evidentohet se data e vendimit të arsyetuar në disa raste nuk përputhet me datën e pasqyruar në të dhënat statistikor, duke pasqyruar në to datën e dorëzimit të vendimit në sekretari. Edhe pas rillogaritjes së kohës mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore referuar të dhënave të depozituar nga gjyqtarja rezultoi se:

- Në kategorinë "Çështje me palë kundërshtare" koha mesatare e arsyetimit është rreth 17 ditë, ***pra më e gjatë*** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.
- Në kategorinë "Çështje pa palë kundërshtare" koha mesatare e arsyetimit është rreth 19 ditë, ***pra më e gjatë*** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.
- Në kategorinë e çështjeve "Marrëdhënie pune" koha mesatare e arsyetimit të vendimit është rreth 15 ditë, ***pra më e gjatë*** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.
- Në kategorinë e çështjeve "Juridiksion fillestar" koha mesatare e arsyetimit të vendimit është rreth 21 ditë, ***pra më e gjatë*** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.

Për sa më sipër, edhe me këto të dhëna koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor, rezulton më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pavarësisht se rezulton më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, gjyqtarja pikëzohet me 9 pikë, duke konsideruar si faktor që ka ndikuar në këtë tregues, kompleksiteti i çështjeve, si dhe volumin e çështjeve.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, pikëzohet me 9 pikë.*

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe raportit analitik, rezulton se nuk ka të dhëna për numrin e seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, *pasi te numri i seancave janë pasqyruar edhe seancat përgatitore në çështjet e kategorisë "Juridiksion fillestar"*, pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, *treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikat mundësohen ne rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short*.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore referuar 3 (tre) nga 6 (gjashtë) çështjet me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, janë shqyrtuar në seancë gjyqësore dhe numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja është ***5.3 seanca gjyqësore.***

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, duke iu referuar akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

- Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet procedurën e kryerjes së njoftimeve, duke verifikuar se njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, si dhe njoftimin e të drejtës së palëve për të paraqitur deri në 5 ditë para seancës parashtrimet me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankimin;
- Shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe të ndryshme. Konkretisht, evidentohet se tre seanca nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues, për shkak të pamundësisë shëndetësore të relatores ose shkarkimin e dy anëtarëve të trupit gjykues në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Në të gjitha rastet e tjera shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: *lënia kohë për plotësimin e të metave të padisë apo kthimi i padisë me të meta, komunikimi për palët joprezente të kërkesës për thirrjen në proces të personit të tretë, komunikimi i akteve palëve, njoftimin e palës paditëse pas vendimmarrjes së gjykatës për kalimin procedural për shkak të ligjit, njoftimin e ekspertit apo për shkak të dhënies kohë palës së paditur për të verifikimin e fakteve të konstatuara në konkluzionet e aktit të ekspertimit, dhënia kohë palëve për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim si dhe shpallja e arsyetuar e vendimit për shkak të kompleksitetit të çështjes.*
- Në rastet e shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale përgjithësisht janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, kur ligji parashikon të tilla *(afati 5 ditor për dhënien kohë palëve për diskutimin përfundimtar apo për shpalljen e arsyetuar të vendimit).*

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin "*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive*", duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri i seancave gjyqësore është 5.3 seanca, por rezulton që gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin e seancave me efektivitet.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri i seancave gjyqësore është më i madh se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive është e lartë, prandaj gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

> ***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi****: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet "1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë", duke e pikëzuar me 15 pikë.*

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 6 (gjashtë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) prej tyre janë shqyrtuar në dhomë këshillimi, 1 (një) çështje është shqyrtuar në seancë gjyqësore dhe 2 (dy) çështje janë gjykuar si juridiksion fillestar, në bazë të kompetencës funksionale të gjykatës.

Në katër çështjet e shqyrtuara në bazë të ankimeve kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë,[51] gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet, duke përgatitur relacionin përkatës, si dhe duke urdhëruar njoftimin e palëve për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes të paktën 15 ditë përpara. Në një rast, gjyqtarja para nxjerrjes së urdhrit për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, ka disponuar me vendim "Për pranimin e kërkesës për përshpejtimin e çështjes".[52] Po kështu, evidentohet se gjyqtarja ka realizuar njoftimin e palëve mbi të drejtën për të paraqitur me shkrim 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrimet e tyre lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim. Seancat për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, përveçse janë dokumentuar me procesverbalin e mbajtur nga sekretarja gjyqësore, janë mbajtur edhe me sistemin e regjistrimit audio.

Në dy çështjet e shqyrtuara si juridiksion fillestar, rezulton se në një prej tyre seanca e parë për kryerjen e veprimeve përgatitore, është zhvilluar brenda afatit 7 ditor të përcaktuar nenin 25 të ligjit nr.49/2012,[53] ndërsa në çështjen tjetër, rezulton se seanca për kryerjen e veprimeve përgatitore është zhvilluar jashtë këtij afati, pas 63 ditësh, por kjo vonesë rezulton të këtë

[51]Çështjet me nr.310 (86-2021-390) vendimi, datë 08.06.2021, nr.411 (86-2021-506) vendimi, datë 14.07.2021, nr.34 vendimi, datë 07.09.2021 dhe nr.67 (86-2021-83) vendimi, datë 01.02.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit

[52]Çështja me nr.411 (86-2021-506) vendimi, datë 14.07.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[53]Çështja me nr.47 (86-2021-461) vendimi, datë 08.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

ardhur si pasoje e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të Pandemisë Covid-19.[54] Në veprimet përgatitore të zhvilluara pas caktimit të çështjeve me short, gjyqtarja kryen me korrektësi dhe në mënyrë të plotë veprimet procedurale të parashikuara në nenin 25 pika 1 të Ligjit nr.49/2012 duke disponuar për plotësimin e të metave të padisë brenda afatit ligjor deri në 10 ditë, për njoftimin e padisë dhe akteve palës së paditur dhe kur është rasti edhe të Avokaturës së Shtetit, bashkë me njoftimin për paraqitjen brenda afati ligjor 10 ditor të prapësimeve me shkrim në sekretarinë e gjyqësore, të listës së personave që i padituri kërkon të thirren në gjykim me cilësinë e dëshmitarit apo të ekspertit dhe adresat e tyre, si dhe të akteve të plota shkresore që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim, sipas nenit 25/1/b të ligjit nr.49/2012. Pas kalimit të afatit për paraqitjen nga pala e paditur të prapësimeve me shkrim dhe të provave, gjyqtarja ka zhvilluar veprimet përgatitore duke evidentuar në procesverbal disponimin kalimin e çështjes për shqyrtim në seancës përgatitore, duke shoqëruar disponimin e gjykatës dhe njoftimin e palës me paralajmërimin se mosparaqitja e provave përpara seancës së parë gjyqësore shkakton mospranimin e tyre. Seancat përgatitore janë zhvilluar në mënyrë korrekte dhe të plotë, duke evidentuar në çdo rast verifikimin e paraqitjes së palëve, relatimin lidhur me aktet e njoftimit të palëve dhe paraqitjen ose jo të tyre. Në rastet kur seanca përgatitore është zhvilluar në mungesë të palës së paditur, pasi ka dëgjuar palën paditëse, gjyqtarja ka relatuar prapësimet me shkrim të paraqitura nga të padituri dhe provat shkresore që janë paraqitur nga pala në mungesë, duke disponuar me vendim për zhvillimin e gjykimit në mungesë. Pas zhvillimit të veprimeve të përcaktuara në nenin 158/b të K.Pr.Civile, gjyqtarja ka disponuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke njoftuar palët se data e caktimit të seancës gjyqësore do tu njoftohej pas formimit të trupit gjykues me 5 (pesë) gjyqtar, në bazë të nenit 12/2/b të ligjit nr.49/2012, i ndryshuar.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio. Seancat gjyqësore rezulton të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre; relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni për palët që nuk janë paraqitur; deponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura; shpalljen e gjykatës; dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake; deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave; administrimin e provave; deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor; deponimin me vendim për kërkesat e palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare duke i dhënë kohë sipas afatit procedural të përcaktuar në nenin 302 të K.Pr.Civile; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar dhe shtyrjen e seancës për shpalljen e vendimit të arsyetuar brenda afatit procedural të parashikuar në nenin 42 pika 2 të ligjit nr. 49/2012.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa nga 2 deri në 15 minuta, që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës. Megjithatë, konstatohet se disa seanca[55] kanë filluar me më shumë se 20 minuta me vonesë, deri në 1 orë me vonesë, nga ora e planifikuar, por në asnjë rast nuk konstatohet që fillimi me vonesë i

[54]Çështja me nr.44 (86-2021-427) vendimi, datë 16.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

[55]Seancat e datave 08.06.2021 dhe 07.09.2021 në çështjen me nr.411 (86-2021-506) vendimi, datë 14.07.2021; seancat e datave 22.06.2020, 03.11.2020, 26.01.2021 në çështjen me nr.67 (86-2021-83) vendimi, datë 01.02.2021; seanca e datës 08.06.2021 në çështjen me nr.310 (86-2021-390) vendimi, datë 08.06.2021; seancat e datave 04.05.2021, 14.06.2021 dhe 24.06.2021 në çështjen me nr.47 (86-2021-461) vendimi, datë 08.06.2021; seancat e datave 30.09.2020, 04.05.2021 dhe 10.06.2021 në çështjen me nr.44 (86-2021-427) vendimi, datë 16.06.2021.

seancës të jetë bërë shkak për dështimin e seancës në dhomë këshillimi, apo të seancës gjyqësore. Shkaku i vonesës në zhvillimin e seancës gjyqësore, në rastet kur ai është relatuar nga gjyqtarja, lidhet me pjesëmarrjen e trupit gjykues në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar, apo problemit teknik të sistemit audio.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në raportin analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja jo gjithmonë ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me afate ligjore, por nga ana tjetër, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në apel administrativ, në dhomë këshillimi, apo në seancë gjyqësore.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi**: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 20 pikë.*

2.C Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik *(sipas datës së aktit)* brenda të njëjtës kategori.

Renditja e akteve në çështjet e shqyrtuar mbi bazë ankimi fillon me aktin e shortit, vijon me relacionin e çështjes, të përgatitur nga kryesuesja e trupit gjykues, urdhrin për njoftimin e palëve ndërgjyqëse, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalin për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, vendimin për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore *(në ato raste kur trupi gjykues ka disponuar për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore)*, vendimin e arsyetuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, parashtrimet e palëve, provat e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar. Ndërsa, në çështjet e shqyrtuar si juridiksion fillestar renditja e akteve fillon aktin procedural të shortit, vijon me kërkesëpadinë dhe provat e paraqitura nga palët, kërkesat procedural të paraqitura nga palët, pretendime dhe konkluzione të palëve me shkrim, njoftimet *(sipas datave)*, procesverbal *"Mbi dokumentimin e veprimeve përgatitore"*, vendim "*Për plotësimin e të metave të padisë"*, vendim "*Për kryerjen e veprimeve përgatitore*" dhe procesverbal mbi kryerjen e veprimeve përgatitore, urdhër *"Për caktimin e seancës përgatitore"*, procesverbale *"Mbi dokumentimin e veprimeve përgatitore"*, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe vendimi gjyqësor përfundimtar.

KONKLUZIONI

Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykatat më të larta. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

> ***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:*** *Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 5 pikë.*

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata në përputhje me veprimet procedurale të kryera prej saj *(njoftimet, procesverbalet e çdo seancë për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi apo për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, vendimet gjyqësore)*, si dhe aktet e paraqitura nga palët *(parashtrimet, prapësimet e palëve)*.

KONKLUZIONI

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

> ***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:*** *Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
82	Shumë mirë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtares. Nuk evidentohen që nga ana e gjyqtares të ketë shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërmbajtje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës.

Ankesat e paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit, të cilat janë trajtuar nga ILD, nuk rezultojnë të kenë evidentuar elementë të cenimit të angazhimit dhe përgjegjshmërisë ne funksion.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 35 pikë.*

3.B Integriteti i gjyqtares

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 843/1 prot., datë 20.04.2022, rezulton se për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, për gjyqtaren {…} janë paraqitur 4 (katër) ankesa. Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultatet e verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

(i) Ankesa e shtetases L.P., ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtares {…} të regjistruar në ILD me nr.3988 prot., datë 28.10.2021, është trajtuar me vendimin nr.3988/2 prot., datë 31.03.2022 ku është vendosur arkivimi i saj, pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar apo mosrespektim të legjislacionit procedural ose material gjatë shqyrtimit gjyqësor, është kompetencë e gjykatave më të larta, në rast të ushtrimit të mjeteve procedurale të ankimit/rekursit ndaj vendimit gjyqësor.

(ii) Ankesës së shtetasit Ll.M, të regjistruar pranë ILD, me nr. 2060 prot., datë 15.04.2021, me urdhër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i janë bashkuar edhe ankesat e tjera të depozituara nga ky ankues pranë KLGJ, dërguar për kompetencë ILD, konkretisht ankesat me nr.1797 prot., datë 25.03.2019, nr.1797/1 prot., datë 27.03.2019 dhe nr.512 prot., datë 21.10.2019. Në lidhje me ankesat e bashkuara, me vendimin nr.2060/2 prot., datë 18.06.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është vendosur arkivimi i tyre, pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet e tij për shkelje të ligjit procedural dhe material janë çështje që zgjidhen nëpërmjet mjeteve të ankimit dhe i përkasin juridiksionit të gjykatave më të larta.

(iii) Ankesa e shtetasit A.B, e regjistruar pranë ILD me nr.1901 prot., datë 02.04.2021, nëpërmjet të cilës ankues ngre pretendimet në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore, është trajtuar vendimin nr.1901/3 prot., datë 06.05.2021 ku është vendosur arkivimin e saj, me arsyetimin se trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar apo

mosrespektim të legjislacionit procedural ose material gjatë shqyrtimit gjyqësor, është kompetencë e gjykatave më të larta, në rast të ushtrimit të mjeteve procedurale të ankimit/rekursit ndaj vendimit gjyqësor.

(iv) Ankesa e shtetasit N.K, e depozituar pranë KLGJ me nr. 1834 prot., datë 09.04.2020, e cila më pas është regjistruar pranë ILD me nr. 2465 prot., datë 21.05.2021. Në lidhje me këtë ankesë, me vendimin nr.2465/3 prot., datë 12.07.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është vendosur: *"Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës të shtetasit N.K...",* me arsyetimin se pretendimet e tij lidhen me çmuarjen e provave dhe zgjidhjen e çështjes, të cilat janë objekt ankimimi dhe kontrolli nga gjykatat më të larta, nëpërmjet ushtrimit të mjeteve të ankimit.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares. Nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga raporti i ILDKPKI, përcjellë në KLGJ me shkresën nr. 720/24 prot., datë 24.03.2022, konkludohet se : *a) deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; d) nuk ka kryer deklarim të rremë; e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Gjyqtarja dhe zv.kryetarja e gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi*: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin "Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti" vlerësohet "Shumë e lartë" dhe pikëzohet me 40 pikë.*

3.C Paanësia e gjyqtares

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me

palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtares.

Gjyqtarja dhe zv.kryetarja e gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

> ***Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi****: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në treguesin "Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.*

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën 01 janar 2021-31 dhjetor 2021, janë paraqitur nga palët 3 (tre) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares {…}, nga të cilat nuk ka asnjë kërkesë të pranuar për përjashtimin e saj nga gjykimi. Ndërkohë, rezulton se gjyqtarja ka paraqitur kërkesë për heqje dorë në 10 (dhjetë) raste, nga të cilat 5 (pesë) kërkesa janë pranuar dhe 5 (pesë) kërkesa janë rrëzuar.

Për këto arsye, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet si "I pakonsiderueshëm" duke qenë se nuk rezulton asnjë kërkesë e pranuar për përjashtimin e gjyqtares nga gjykimi.

> ***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi****: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin "Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit", ky numër është "I pakonsiderueshëm", prandaj pikëzohet me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparent, dhe e kuptueshëm. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: *Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Komunikimi i qartë dhe transparent" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.*

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: *Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale" vlerësohet "I lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.*

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Në vlerësimin e zv.kryetares së gjykatës evidentohet dhe vlerësohet maksimalisht aftësia e gjyqtares për të bashkëpunuar dhe shkëmbyer njohuritë me koleget dhe për të ndarë përvojën profesionale.

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

> ***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi****: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.*

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta, fakt që evidentohet dhe në vlerësimin përfundimtar të zv.kryetares së gjykatës si një element të cilit gjyqtarja i kushton rëndësi të veçantë.

> ***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi****: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore" vlerësohet "Shumë e lartë" duke u pikëzuar me 10 pikë.*

4.C Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertes.[56]

Konkretisht evidentohet se gjyqtarja {…}, përgjatë vitit kalendarik 2021, ka marrë pjesë në 3 (tre) aktivitete trajnuese si eksperte, konvertuar në numër ditësh 10 ditë,[57] kohëzgjatje kjo që është brenda kufijve të parashikuar nga 5 deri në 40 ditë në vit, në periudhën një vjeçare të vlerësimit.

---

[56]Shkresa me nr. 293/5 Prot., datë 27.05.2022 e Shkollës së Magjistraturës.

[57]Rregullorja e Brendshme e Shkollës së Magjistraturës në pikën 9 të nenin 55 të saj, parashikon : "Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë: 1 ditë pjesëmarrjeje **si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;** 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Gjithashtu referuar formularit të integruar të vlerësimit, lidhur me trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, rezulton se gjyqtarja ka deklaruar se ka marrë pjesë në trajnimin ndërkombëtar me temë "Mbi procedurat e gjykimit në Gjykatën Europiane të Drejtësisë", të nga autoritet e Bashkimit Europian, *online* në datat 11-13 tetor 2021.[58]

> ***Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi****: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale është nga 5-40 ditë në vit (për periudhën e vlerësimit viti 2021) duke u pikëzuar me 20 pikë.*

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {…} përgjatë vitit kalendarik 2021, ka marrë pjesë në 3 (tre) aktivitet trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e ekspertes konkretisht në trajnimet me temë:

1. *"Pavlefshmëria absolute dhe paligjshmëria në analizën e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit, "Për Gjykatën Administrative. Të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre. Raporti ndërmjet anulimit dhe shfuqizimit të aktit administrativ; Anulim, shfuqizim apo konstatim i akteve administrative; Anulim dhe shfuqizim i aktit administrative të paligjshëm/të ligjshëm; Anulim dhe shfuqizim i aktit administrativ në një proces të nisur kryesisht dhe/ose mbi bazë ankimi";*
2. *"Gjykimi administrative në fushën e doganave, roli i taksimit të dyfishtë, si aplikohet"*
3. *"Probleme të praktikës gjyqësore lidhur me TVSH dhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane lidhur me TVSH".*

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për ketë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {…} duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e ekspertes në aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

> ***Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi****: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, pikëzohet me 5 pikë.*

[58]Nuk rezulton që bashkëlidhur formularit të integruar gjyqtarja të ketë ka paraqitur njoftimin për pjesëmarrjen apo akte të tjera lidhur trajnimin e sipërcituar.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik dhe dosjes personale të gjyqtares {…} rezulton se gjyqtarja gjatë vitit 2021 është angazhuar në veprimtarinë e mësimdhënies në Shkollën e Magjistraturës, si pedagoge e jashtme, në Programin e Formimit Fillestar, në lëndët "E drejtë administrative", dhe "E drejtë e punës dhe sigurimet shoqërore".

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për ketë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {…}, ky tregues pikëzohet me 5 pikë, pasi rezulton angazhimi i saj në veprimtarinë e mësimdhënies.

> ***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi****: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues pikëzohet me 5 pikë.*

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, gjyqtarja ka shpjeguar në vetëvlerësimin e saj se gjatë vitit 2021 në cilësinë e ekspertes në Shkollën e Magjistraturës ka dorëzuar në çdo rast material të shkruara për temat e caktuara për trajnim duke evidentuar probleme ligjore, të praktikës dhe nxitur debatin e mendimin juridik. Të gjitha këto materiale janë të dorëzuara në Shkollën e Magjistraturës duke u përfshirë në fondin e materiale juridike të shkollës, për të cilat gjyqtarja parashtron se ka dhënë edhe pëlqimin për publikim. Bashkëlidhur formularit të integruar gjyqtarja nuk ka paraqitur materialet e përgatitur dhe të botuar nga Shkolla e Magjistraturës në botimit e saj shkencore. Lidhur me këtë tregues gjyqtarja në provat e paraqitura bashkëlidhur kundërshtimeve të saj ka depozituar pjesë të *scanuar* të Revistës Juridike Shkencore të Shkollës së Magjistraturës, numër 2 e vitit 2021, ku është botuar artikulli teorik "*Pushteti diskrecional i organeve publike dhe kontrolli ndaj tij"* me bashkautorësi.
Sa më sipër, në kushtet kur gjatë vitit 2021, gjyqtarja ka realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës, gjyqtarja {…}, lidhur me këtë tregues vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

> ***Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi****: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin "Publikime ligjore akademike" rezulton angazhimi i gjyqtares dhe për këtë ky tregues pikëzohet me 5 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	82	Shumë mirë
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	100	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	382	Shumë mirë

REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja "ç" të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {…}, pavarësisht ngarkesës së çështjeve, duhet të organizojë punën dhe menaxhoj kohën, duke i dhënë prioritet shqyrtimit të çështjeve për të cilat ligji parashikon afat brenda të cilit ato duhet të gjykohen. Gjyqtarja duhet të mbajnë në konsideratë pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR